



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 20, lidhur me neni 25, të Ligjit Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 67/2010”, konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 31.10.2018, miraton këtë;

V E N D I M

Për miratimin e programeve komunal (3) tre vjeçare për banim 2019-2021

Neni 1

Me këtë vendim miratohen programet komunal (3) tre vjeçare për banim për periudhën 2019-2021 për Komunën e Suharekës.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendim janë programet komunal (3) tre vjeçare për banim për periudhën 2019-2021, për Komunën e Suharekës, i hartuar nga grupi punues i Komunës së Suharekës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-104-69856
Me datë 31.10.2018

